

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, si dhe gjyqtarët Kymete Kicaj dhe Luan Berisha si anëtarë të trupit gjykues, e me procesmbajtësen Birsen Kume - sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Xh. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340, par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren me nr. PP.nr.3090/2009 të datës 30.01.2012, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Ervehe Gashi, të akuzuarit Xh. B. dhe mbrojtësit të tij E. G., më datë 29.06.2015, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Xh. B., nga i ati B. dhe e ëma M., e lindur A., data e lindjes... në fshatin D., Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPPK.

LIROHET NGA AKUZA

Se me datën 03 Shtator 2009, në cilësi të personit zyrtar, e deri sa ka qenë në orar të punës si polic pranë Qendrës për Mbajtje të Stacionit Policor në Prizren, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete, përvetëson shumën e parave prej 75 (shtatëdhjetepesë) eurosh, para këto të besuara atij, në bazë të detyrës që e kishte, në atë mënyrë që nga sendet personale të të dëmtuarit S. Z. nga fshati P. Komuna e Gj., i cili ishte në ndalim, merr shumën prej 75 (shtatëdhjetepesë) euro, nga 220 (dyqindnjëzet) euro, të cilat i kishte në momentin e ndalimit, e që është vërtetuar nga vërtetimi për marrjen e përkohshme të sendeve nga zyrtarët e policisë së pikës kufitare në Vërmicë lidhur me rastin 2009-YWG-082 të datës 02 Shtator 2009 dhe me rastin e dorëzimit të të dëmtuarit dhe sendeve të tija zyrtarëve që transportojnë për në Qendrën Korrektuese në Lypjan së bashku me sendet tjera dorëzon para në shumë prej 145 (njëqindkatërdhjetëepesë) euro, duke përmirësuar paraprakisht edhe formën e regjistrimit PZ-3121-09 të datës 02.09.2009, me ç'rast në këtë formular shënon shumën prej 145 (njëqindkatërdhjetëepesë) euro, e për të cilën shumë dhe mungesë të parave prej 75 eurosh, i dëmtuari kupton në momentin e regjistrimit në Qendrën Korrektuese të Lypjanit.

Këso dore do të kryente veprën penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340, par.1 të KPK-së.

Pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën nën numrin PP.nr.3090/2009 të datës 30.01.2009 kundër të akuzuarit Xh. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par.1 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit Ervehe Gashi në fjalën përfundimtare të cilën e dorëzoi edhe në formën e shkruar, ka ngelur pranë aktakuzës së parashtruar PP.nr.3090/2009 të datës 30.01.2009 kundër të akuzuarit Xh. B., nga Prizreni, për veprën penale për të cilën ngarkohet, në të cilën edhe e ka bërë precizimin e përshkrimit faktik të veprës penale, duke shtuar se gjendje faktike është vërtetuar nga provat materiale të administruara dhe deklaratat e dëshmitarëve të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor – siç janë deklaratat e dëshmitarëve oficerëve policor të Qendrës së Ndalimit të Stacionit Policor në Prizren, S. U., S. H., H. I., B. M. dhe S. Q., me leximin e deklaratës së dëmtuarit S. Z. si dhe nga provat materiale siç janë: vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve 2009-YWG-085 të dt. 02.09.2009 të NJAPKK Vërmicë, regjistri i gjërave të marra nga policia i dt. 02.09.2009 dhe formën e regjistrimit PZ -3212/09. Andaj, thekson se kronologjikisht shikuar, të gjitha mospërputhjet janë lajmëruar në momentin kur i akuzuari Xh. B., ngarkohet me ndërrim, ku i akuzuari e ka vërejtur mospërputhjen e shumave të parave nëpër formularë, ka heshtur për këtë, e plotëson formularët PZ-3212/09 duke vendosur shumën prej 145 eurove te vendi të hollat. Po ashtu ka theksuar se në asnjë dokument të përgatitur nga ana e të akuzuarit lidhur me transferin e të dëmtuarit nuk është nënshkruar nga i dëmtuari e as zyrtari i ngarkuar me transfer – dëshmitari S. Q. Andaj, nga kjo rezulton se i akuzuari këto veprime i ka ndërmarrë qëllimisht për të fshehur veprimin e mungesës së parave, të cilat i ka përvetësuar nga i dëmtuari. Andaj, nga këto veprime të cekura është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit Xh. B. formohen elementet e veprës penale me të cilin ngarkohet, kështu i propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike i ka nxjerrë të gjitha provat e domosdoshme dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi konstatoi se nuk është provuar se i akuzuari Xh. B. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesorë i ka administruar të gjitha provat dhe atë ka dëgjuar dëshmitarët B. M., S. U., H. I., S. H. dhe S. Q., gjithashtu ka nxjerrë edhe provat tjera materiale dhe atë: Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve të lëshuar nga njësia e pikës kufitare në Vërmicë me nr. 2009-YËV 0082 e dt. 02.09.2009; Shkresa – të dhënat mbi pronën-sendet e personit të pranuar e dt.02.09.2009; Orari i punës për zyrtarët policorë pranë stacionit policor në Prizren e dt. 03.09.2009; Raporti ditor i Qendrës së Ndalimit të Stacionit Policor në Prizren i dt.02.09.2009; Raporti ditor i Qendrës së Ndalimit të Stacionit Policor në Prizren i dt.03.09.2009; Fotokopja e nxjerrur nga ditari i punës për pranim-dorëzim të detyrës të Qendrës së Ndalimit në Prizren për ditët 02, 03 dhe 04 të muajit Shtator të vitit 2009; raportin e ekzaminimit dhe vlerësimit forenzikë të kompjuterit e pikërisht të softverit të kompjuterit, punuar nga eksperti V. P. i dt. 26.10.2009 në bazë të urdhëresës së gjyqtarit të procedurës paraprake me nr. P.ndr. 663/09 të dt. 11.09.2009.

Mbrojtësi i të akuzuarit – avokati E. G., në fjalën përfundimtare deklaroj se edhe pas precizimit të dispozitivit të akuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, në tërësi e ka kundërshtuar akuzën e cila juridikisht dhe faktikisht është e paqëndrueshme. Nga administrimi i provave rrjedh konstatimi se në veprimet e mbrojturit të tij nuk janë formuar elementet e veprës penale të përvetësimit gjatë ushtrimit të detyrës nga neni 340 par. 1 i KPK-së, e këtë e bazon në regjistrat e policisë përkatësisht në regjistrin për të cilën thirret organi i akuzës PZ.3219/09 të datës 02.09.2009, i cili formular në momentin kur është dorëzuar për transfer i dyshuari S. Z. së bashku me gjësendet e tjera, është nënshkruar nga ana e personit përgjegjës edhe pranimit i këtyre mjeteve dhe i gjësendeve, për të cilën përgjegjësia bie drejtpërsëdrejti në momentin e pranimit të gjësendeve pa i kontrolluar, duke theksuar se përgjegjësia e mbrojturit të tij në këtë rast evitohet ose nuk qëndron me vet faktin e plotësimit dhe nënshkrimit të formularëve, sepse kjo çështje penale nuk ka shkuar sipas rregullit prej fillimit kur është bërë dorëzimi i dyshuari S. Z. nga policia kufitare në Vermicë në Qendrën e Ndalimit në Prizren e deri në transferimin e tij në burgun e Lipjanit, i cili fakt është vërtetuar nga dëgjimi i policëve në cilësinë e dëshmitarëve dhe atë H. I., S. U., S. H., B. M. dhe S. Q. i cili në seancën e fundit gjyqësore ka deklaruar se nuk i kanë numëruar të hollat, nuk i kanë kontrolluar gjësendet përveç se i kanë nënshkruar formularin e kanë pranuar të dyshuarin, ndërsa mungesa e të hollave është hetuar kur i dyshuari është dorëzuar në Qendrën e Paraburgimit Lipjan, kur nuk ishte prezenca e policit. Duke parashtrua një pyetje logjike se si mund të jetë i mbrojturi i tij përgjegjës në këtë çështje për deri sa i njëjti në mënyrë të rregullt pa vërejtje e ka dorëzuar formularin i cili përputhet edhe me formën e shkruar në kompjuter dhe asnjëri prej ndryshimeve të cilët kanë bërë pranimin ose dorëzimin nuk i kanë numëruar të hollat apo gjësendet e tjera por të gjithë ato i kanë dhënë në besim. Andaj, bazuar në këtë gjendje faktike konsideron se përgjegjësia duhet të jetë e ose e gjithë stafit ose jo vetëm e mbrojturit të tij, sepse nuk mohohet faktin se kanë munguar 75 euro, të cilin e vërteton formulari për ndalim në pikën kufitare në Vermicë, i cili formular nuk ka qenë në dosjen e klientit – dyshuarit por ka qenë në xhepin e të dyshuarit dhe atë në Lipjan gjatë bastisjes të njëjtë, dhe në rastin konkret janë paraqitur dilema se kush ka mund këto të holla ti merr nga qesja e gjësendeve në dosjen e të dyshuarit. Prandaj, bazuar në provat materiale të administruar dhe lidhur me dispozitën e nenit 3 të KPK-së, gjykata duhet të vendos në favor të akuzuarit se i njëjti është kryes i veprës penale, duke propozuar trupit gjykues që të njëjtin në mungesë të provave ta liroj nga përgjegjësia penalo-juridike.

I akuzuari Xh. B., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se në ditën kritike ka ardhur në Qendrën e Ndalimit në ora 15:10 minuta, në vendin e punë ka qenë oficeri B., i cili e kishte njoftuar të akuzuarin se në ndalim janë 3 persona, prej të cilëve vetëm njëri kishte pasur para në shumën prej 2.20 euro. Gjatë kontrollimit të qeseve me gjësendeve të paraburgosurve, i akuzuari ka vërejtur se aty nuk janë vetëm 2.20 euro por kishte edhe karmonedha, mirëpo B. nuk kishte prituri më shumë në Qendër dhe kishte dalur, ndërsa i akuzuari për këtë e kishte marrë formularin dhe në qeli e ka njoftuar të paraburgosurin Z. se në formular shkruan se ke pasur 2.20 euro ndërsa në protokoll e tij janë 145 euro, ai ishte drejtuar “çdo gjë është në rregull lërmë rahat dua të pushoj”. Pas marrjes së urdhrat për transferim e paraburgosurit, i akuzuari në prani të paraburgosurit – dëmtuarit Z. dhe policit S. në zyre i kanë kontrolluar gjërat e konfiskuara një nga një dhe më pas nga kompjuteri ka nxjerrë një formularë, i kanë numëruar paratë dhe pasi që çdo gjë ishte në rregull, të gjithë palët u nënshkruan dhe shkuan. Më vonë pas kthimit të patrullës në Prizren, polici S. Q. e kanë njoftuar të akuzuarin se ka probleme rreth shumës së parave të paraburgosurit, të njëjtë i mungonin disa para, i cili në atë moment e kishte nxjerrë një formular të përpiluar në kufi të cilin i paraburgosuri e kishte pasur në xhep, dhe pas krahasimit me formularin të cilin i akuzuari e kishte nxjerrur më herët nga kompjuteri, kishte një mospërputhje, atëherë ishte drejtuar policit S. se unë ti kam dorëzuar 145 euro dhe çdo gjë a qenë në rregull kur e ke pranuar të paraburgosurin për transfer. Më tej ka theksuar se formularin e përpiluar në kompjuter e ka përpiluar kolegu i tij H. I. i cili edhe e ka pranuar të paraburgosurin në ndalje, ndërsa i akuzuari ka nënshkruar formularin mbi transferimin e të

paraburgosurit-dëmtuarit, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me pohimet e mbrojtësit të tij, duke theksuar se fatkeqësisht z. Z. është vjedhur nga ana e policisë, ndërsa policit hetues me emër L. i cili punon në stacionin regjional të policisë, i ka thënë që nga buxheti i policisë të i kthehen shuma e marrë z. Z., e me qëllim që të ruhet integriteti i policisë, ndërsa për këtë duhet të gjendet personi i cili i ka marrë këto të holla, mirëpo lidhur me këto nuk është ndërmarrë asgjë. Nuk e ndien vetëm fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se do të respektoj çdo vendim të gjykatës.

Gjykata duke analizuar deklaratën e të akuzuarit pjesërisht ia fali besimin kësaj deklaratë. Besimin ia fali vetëm sa i përket asaj pjese të deklaratës ku i njëjti deklaroi se ka qenë në ndërrim kur deklaroi se ndërrimin e ka pranuar nga polici B. M., si dhe në pjesën kur deklaroi se të dëmtuarin S. Z. ia ka dorëzuar policit S. Q. për transfer, si dhe faktin se po ky polic e ka njoftuar të akuzuarin se ka probleme rreth shumës së parave të paraburgosurit, të njëjtit i mungonin disa para, mirëpo gjykata nuk ia fali besimin asaj pjese të deklaratës së të akuzuarit ku i njëjti deklaroi se me rastin e pranimit të ndërrimit i ka verifikuar gjësendet e të dëmtuarit S. Z. gjithashtu se i ka numëruar paratë, pasi që kjo deklaratë është në kundërshtim me provat tjera të administruara si dhe nga vet dëshmitë të dëshmitarëve B. M. i cili deklaroi se nuk i kanë verifikuar gjësendet e të ndaluarit por edhe të dëshmitarit S. Q. i cili ka deklaruar se nuk i kanë verifikuar gjësendet e të dëmtuarit me rastin e marrjes së tij për transfer.

Gjatë procedurës së provave është dëgjuar dëshmitari B. M. i cili ka deklaruar se në ditën kritike në Qendrën e Ndalimit në Prizren ka qenë në detyrë prej orës 08:00 – 16:00, së bashku me kolegun S. H., i cili atë ditë e kishte pranuar ndërrimin në ora 07:00. Dikur rreth orës 14:25, S. H. i ishte drejtuar atij se nuk ndiet mirë me shëndet dhe i njëjti pasi që ka marrë leje nga eprorët e tij kishte shkuar në shtëpi, ndërsa ai kishte vazhduar me punë në Qendër, dhe aty diku rreth orës 14:45 kishte ardhur nderimi përkatësisht Xh. B. për ta pranuar detyrën. Ka theksuar se në prezencën e kolegut Xh. ka marrë lëndën dhe aty e ka hapur gjësendet e konfiskuara të hollat ku figuronte 2.20 euro, duke ia ka dorëzuar qesen me sendet e konfiskuara, ndërsa i akuzuari i ishte drejtuar në gjuhën boshjake “bato tebi ti verujem” dhe e ka mbyllur lënë, të cilat holla në momentin e pranimit – dorëzimit nuk i kishin numëruar nga ana e dëshmitarit dhe i akuzuari.

Gjykata ia fali besimin deklaratës së këtij dëshmitari ngase përputhet edhe me deklaratat e dëshmitarëve tjerë si dhe me provat materiale, dhe nga kjo dëshmi vërtetohet se i njëjti me rastin e dorëzimit të ndërrimit të akuzuarit fare nuk e ka bërë kontrollimin e gjësendeve të ndaluarit e as që i ka numëruar të hollat që të njëjtit i janë konfiskuar përkohësisht.

Nga dëgjimi i dëshmitarit S. U. i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 02.09.2009 në ora 23:00 ka pranuar detyrën në Qendrën e Ndalimit në Prizren nga kolegu i tij H. I., duke theksuar se në këtë Qendër në atë kohë ka qenë i ndaluar ka qenë i dyshuari – dëmtuari S. Z., dhe nga gjësendet e konfiskuara të tij personale kanë qenë edhe të holla në shumën prej 220 euro, me apoena prej 20,10 dhe 5 euro. Pas përfundimit të detyrës të nesërmen me datë 03.09.2009 në ora 7:00 të mëngjesit detyrën e ka dorëzuar kolegut S. H. së bashku me gjësendet e konfiskuara të S. Z., të cilët pas verifikimit janë numëruar dhe janë nënshkruar në librin e pranimit dorëzimit.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit S. U. gjykata ia fali besimin kësaj dëshmie.

Nga dëgjimi i dëshmitarit H. I., i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me datë 02.09.2009 nga ora 15:00 e deri më 23:00 ka qenë me detyrë në Qendrën e Ndalimit në Prizren, dhe ai po atë ditë në ora 15:20 min ka pranuar nga policët kufitar të ndaluarin - dëmtuarin S. Z., i cili prej gjësendeve të konfiskuara nga i ndaluari - dëmtuari ka pranuar edhe një shumë të hollave prej 220 euro, të cilat shënime janë shënuar në formularin e pranimit dhe janë ruajtur gjatë kohës sa i ndaluari

- dëmtuari ka qenë në ndalim. Ka theksuar se nga polici i rastit në Vërmicë ka pranur një dokument në të cilën shënohen gjësendet e konfiskuara, të cilën një kopje e mbajnë në Qendrën e Ndalimit ndërsa kopje tjetër i është dhënë të ndaluarit. Gjithashtu përveç këtyre kopjeve, në stacion - qendrën e ndalimit përpilohen edhe dy kopje tjera, ku regjistrohen gjësendet e konfiskuara.

Nga dëgjimi i dëshmitarit S. H., i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike në Qendrën e Ndalimit ka filluar me punë në ora 07:00 të mëngjesit, mirëpo për shkak të problemeve shëndetësore me sy, ishte larguar më herët nga puna. Gjatë pranimit – dorëzimit të detyrës nga S. U., të hollat dhe gjësendet e konfiskuara nga i dëmtuari – ndaluarit nuk i kishte verifikuar, për arsye të besimit që kishte ndaj kolegëve të tij. Me tej ka theksuar se gjatë pranimit dorëzimit të detyrës në tre vende të posaçme shënohen se është bërë pranimit – dorëzimi i detyrës në gjendje të rregullt, e cila një formë është e përpiluar në kompjuter, një formë tjetër e përpiluar në fletore të thjeshtë e formatit A4 e Qendrës së Ndalimit, në të cilën fletore shënohet pranimit dorëzimi i detyrave ndërsa forma e tretë është kur zyrtari policor në formën e veçantë të përgatitur në kompjuter shënohet veprimet gjatë ditës lidhur me të ndaluarit, duke theksuar se të gjitha këto formularë duhet të përputhen me njëra tjetrën.

Nga dëgjimi i dëshmitarit S. Q., i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike së bashku me kolegen N. Sh. kanë bërë transferimin e paraburgosurit - dëmtuarit S. Z. nga Qendra e Ndalimit në Prizren në burgun e Lipjanit, dhe deri në pranimit e tij në burgun e Lipjanit çdo gjë ka qenë në rregull, mirëpo pas kontrollimit të gjësendeve të paraburgosurit – dëmtuarit nga ana e gardianëve të burgut, pa prezencën e tyre është vërejtur se të dëmtuarit i mungojnë të hollat. Më tej thekson se gjësendet e të dëmtuarit kanë qenë të paketuara në qese plastike të mbyllura, të cilën e kanë dorëzuar ashtu si e kanë pranuar nga polici – i akuzuari Xh. B. dhe të cilat nuk janë kontrolluar nga dëshmitari.

Gjykata ia fali besimin dëshmisë së këtij dëshmitari dhe se dëshmia e tij përputhet në tërësi edhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është lexuar deklarata e dëshmitarit – dëmtuarit S. Z. e dhënë me datë 25.09.2009 në burgun e Lipjanit, para hetuesve të Njesisë së Hetimeve Regjionale të Drejtorisë Rajonale të policisë në Prizren, i cili ka deklaruar se me datë 02.09.2009 është arrestuar në pikën kufitare në Vërmicë, po atë ditë është transferuar në Qendrën e Ndalimit në Prizren. Përveç gjësendeve personale ka pasur edhe 220 euro, të cilat janë regjistruare në listën e gjësendeve personale. Ndërsa, të nesërmen pasi që është transferuar në burgun e Lipjanit, gjatë pranimit të tij në burg dhe kontrollimit të gjërave personale nga oficerët e burgut e në prani të policëve nga Prizreni, ka kuptuar se i mungojnë 75 euro, duke dëshmuar oficerëve se i njëjti në kohën e arrestimit ka pasur 220 euro të konfiskuara. Thekson se formën PZ-3212 09, ku janë të dhënat personale nuk ka nënshkruar, por vetën formën mbi të dhënat e pronës. Gjatë transferimit për në burgun e Lipjanit, të hollat kanë qenë të mbështjellura në qese najloni të cilat nuk kanë qenë të hapura fare.

Me leximin e vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të sendeve e lëshuara nga njësia e pikës kufitare Vërmicë me nr. 2009-YWG 0082 e datës 02.09.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se në momentin e ndalimit të paraburgosurit – dëmtuarit S. Z. janë konfiskuar shuma prej 220 eurove dhe atë 9 kartëmonedha nga 20 euro, 3 kartëmonedha nga 10 euro, dhe 2 kartëmonedha me nga 5 euro.

Nga shikimi i shkresës – të dhënat mbi pronën –sendet e personit të pranuar të datës 02.09.2009, gjykata ka vërtetuar se nga përshkrimi i gjësendeve të ndaluara të dëmtuarit janë edhe para në shumën prej 2.20 euro.

Nga shikimi i formës së regjistrimit (REGISTRATION FORM) PZ-3212/09 i përpiluar nga zyrtarët policorë me rastin e pranimit të dëmtuarit S. Z. e datës 02.09.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se në gjësendet e marrura të dëmtuarit është shuma prej 145 euro, ku në rubrikën dorëzim nuk ka nënshkrim, ndërsa në rubrikën e pranoi qëndron nënshkrimi dhe nr. ID 1279, i cili ID nuk korrespondon me ID e të akuzuarit pra nuk është nënshkruar nga i akuzuari Xh. B.

Me leximin e orarit të punës për zyrtarët policor, pranë stacionit policor në Prizren e datës 03.09.2009, gjykata ka vërtetuar identifikimin të gjithë policëve të cilët kanë punuar në Qendrën e Ndalimit në Prizren prej datës 02-03.09.2009, në kohën kur edhe është mbajtur në ndalim i dëmtuari S. Z.

Me leximin e raportit ditor të Qendrës së Ndalimit Policor në Prizren datë 02.09.2009 dhe 03.09.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se, nga zyrtarët policor nuk ishte evidentuar ndonjë parregullsi lidhur me pranim-dorëzimin e detyrës në Qendrën të Ndalimit Policor.

Me leximin e fotokopjes së nxjerrë nga ditari i punës për pranim dorëzimin e detyrës të Qendrës së Ndalimit në Prizren për datat 2,3 dhe 04.09.2009, gjykata ka vërtetuar faktin gjatë pranim dorëzimit të detyrës nga zyrtarë në këtë qendër nuk ishte evidentuar ndonjë parregullsi.

Me leximin e raportit i ekzaminimit dhe vlerësimit forenzikë të kompjuterit – softueri të kompjuterit nga eksperti V. P. i dt. 26.10.2009, e në bazë të urdhëresës së gjyqtarit të procedurës paraprake Pndr. nr. 663/09 dt. 11.09.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se nga kjo ekspertizë nuk është vërtetuar ndonjë dëshmi lidhur me dokumentin – formularin PZ-3212/09, se kur është regjistruar, kur është ndryshuar dhe kur është printuar dokumenti nga shtëpiza e kompjuterit e cila ka qenë në Qendrën e Ndalimit në Prizren, i cili është shfrytëzuar nga oficerët policor në këtë Qendër.

Nga të gjitha provat e administruara si dhe nga dëgjimi i dëshmitarëve gjykata konstatoi se nuk është kontestuese se i dëmtuari S. Z. me datën 02.09.2009, është ndaluar si i dyshuar nga Njësi i Hetuesisë të Policisë Kufitare në Vërmicë, me këtë rast përkohësisht i janë konfiskuar sende të ndryshme në mes tjerash edhe shumën e të hollave prej 220 euro, po ashtu nuk është kontestuese se të njëjtit me rastin e transferit në burgun e Lipjanit i kanë munguar shuma e të hollave prej 75 euro. I dëmtuari S. Z. me datën 02.09.2009 dërgohet në qendrën e ndalimit në Prizren të cilin e pranon polici H. I. i cili në dokumentin mbi sendet e personit të pranuar në mes tjerash shënon shumën e parave dhe atë 2.20 euro pa e precizuar llojin e kartëmonedhave, por sipas deklaratës së tij ka qenë gabim teknik pasi që i ka pranuar 220 euro, po ky dëshmitar deklaroi se ka plotësuar edhe një formular në kompjuter (REGISTRATION FORM) PZ-3212/09 datë 02.09.2009, ku ka regjistruar se para të gatshme kanë qenë 220 euro, ndërsa gjykata me rastin e administrimit të këtij formulari ka vërtetuar se në formularë shihet se kanë qenë të shkruara 145 euro dhe ka qenë i vendosur nënshkrimi i policit dhe numri i tij e të cilët nuk kanë qenë të akuzuarit Xh. B., ky formular është dërguar në ekzaminimit dhe vlerësimit forenzikë dhe nga raportit i ekzaminimit dhe vlerësimit forenzikë të kompjuterit – softueri të kompjuterit nga eksperti është vërtetuar se nga ekspertiza nuk është mundur që të vërtetohet ndonjë dëshmi lidhur me dokumentin – formularin PZ-3212/09, kur është regjistruar, ndryshuar dhe printuar dokumenti nga shtëpiza e kompjuterit e cila ka qenë në Qendrën e Ndalimit në Prizren, i cili është shfrytëzuar nga oficerët policor në këtë Qendër. Polici H. I. sipas shkresës së policisë në orarin e ndërrimeve ka qenë në detyrë me datën 02.09.2009 nga ora 15:00 deri ora 23:00. Në ora 23:00 të datës 02.09.2009 pas verifikimit të gjësendeve të ndaluarit dhe numrimit të hollave nga vet ai dhe polici S. U. ndërrimin ia dorëzon policit S. U. i cili raporton se detyrën e ka pranuar në mënyrë të rregullt dhe në ndërrim qëndron deri në ora 07:00 të datës

03.09.2009 kur e dorëzon ndërrimin tek polici S. H. i cili e ka pranuar ndërrimin dhe nuk i verifikojnë gjësendet me këtë rast nuk i numërojnë të hollat e të dëmtuarit e kjo për arsye besimi të ndërsjellët në mes kolegëve, në ndërrim ka qenë edhe B. M., të cilët kanë qenë të obliguar për të qëndruar deri në ora 15:00 të datës 03.09.2009, polici S. H. 15 minuta para përfundimit të ndërrimit largohet nga vendi i punës për arsye shëndetësore, polici B. M. rreth orës 15:00 të datës 03.09.2009 ia dorëzon ndërrimin të akuzuarit Xh. B. dhe me rastin e pranim dorëzimit të detyrës fare nuk kanë bërë kontrollimin përkatësisht verifikimin e gjësendeve të personale të personave që ishin të ndaluar, me këtë rast edhe të sendeve të S. Z. pra nuk i kanë numruar të hollat. Pas pranimit të ndërrimit nga i akuzuari, diku rreth orës 19:00 të datës 03.09.2009 i dëmtuari S. Z. transferohet në burgun e Lipjanit, të cilin e merr polici S. Q. i cili po ashtu nuk bën fare verifikimin e gjësendeve të ndaluarit pra nuk bën numrin e parave, por e merr të dyshuarin në këtë rast të dëmtuarin S. Z. dhe tek pasi që mbërrijnë në burgun e Lipjanit pas verifikimit vërtetohet se mungojnë një shumë e caktuar e të hollave përkatësisht mungojnë 75 euro.

Veprimi kryes të cilin sipas akuzës e ka kryer i akuzuari Xh. B. është “*se i njëjti ka përmirësuar formularin PZ-3212/09 të datës 02.09.2009 me ç’rast në këtë formular shënon shumën prej 145 euro*”, mirëpo ky fakt nuk është vërtetuar, pasi që nga raportit i ekzaminimit dhe vlerësimit forenzikë të kompjuterit – softueri të kompjuterit nga eksperti V. P. i dt. 26.10.2009, nuk është vërtetuar ndonjë dëshmi lidhur me dokumentin – formularin PZ-3212/09, se kur është regjistruar, kur është ndryshuar dhe kur është printuar dokumenti nga shtëpiza e kompjuterit e cila ka qenë në Qendrën e Ndalimit në Prizren, i cili është shfrytëzuar nga oficerët policor në këtë Qendër dhe po ky formular nuk është i nënshkruar nga i akuzuari.

Pra nga të gjitha këto vërtetohet se që nga pranimi i të dëmtuarit S. Z. në qendrën e ndalimit në Prizren e deri te transferimi i tij në burgun e Lipjanit kanë punuar 6 policë në 5 ndërrime, me rastin e pranimit të tij polici H. I. verifikon gjësendet e tij dhe përpilon dy formular, në njërin shënohen 220 euro ndërsa në tjetrin sipas policit H. I. edhe aty shënohen 220 por në formular shihet se është shuma 145 euro, e që nuk është vërtetuar se kush e ka ndryshuar shumën e të hollave në këtë formular ngase nga ekspertiza nuk është vërtetuar ndonjë dëshmi lidhur me dokumentin – formularin PZ-3212/09 i cili dokument nuk është i nënshkruar nga i akuzuari, nuk dihet se kur është regjistruar, ndryshuar dhe printuar dokumenti nga shtëpiza e kompjuterit e cila ka qenë në Qendrën e Ndalimit në Prizren, po ashtu me rastin e pranim dorëzimit të ndërrimeve nga H. I. tek S. U. janë verifikuar gjësendet e të ndaluarit, ndërsa pas dorëzimit të ndërrimit nga S. U. tek polici S. H. fare nuk verifikohen gjësendet e gjithashtu edhe pas dorëzimit të ndërrimit nga B. M. tek i akuzuari Xh. B. nuk kontrollohen gjësendet dhe nuk numërohen paratë e që përsëri me rastin e dorëzimit për transfer të të ndaluarit S. Z. tek polici S. Q. nuk kontrollohen gjësendet e të ndaluarit pra fare nuk numërohen të hollat, ndërsa në raportet ditore të Qendrës së Ndalimit Policor në Prizren datë 02.09.2009 dhe 03.09.2009, nga zyrtarët policor nuk ishte evidentuar ndonjë parregullsi lidhur me pranim-dorëzimin e detyrës në Qendrën të Ndalimit Policor, por tek pasi që i ndaluari paraqitet para zyrtarëve të burgut në Lipjan aty kuptohet se i mungojnë një sasi e të hollave.

Pra nga këto fakte të vërtetuar gjykata erdhi në përfundim se nuk ka prova të cilat do të vërtetonin se i akuzuari Xh. B. ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar dhe të njëjtin në mungesë provash e liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 454 par. 1 të KPP.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
P.nr.309/2013 më datë 29.06.2015**

**Procesmbajtësja
Birsen Kume**

**Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës se Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.